



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 1145, datë 24.12.2020

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN  
E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT ARSIMOR SHKOLLA 9-VJEÇARE  
“HAJDAR ZOGU”, FSHATI TAPIZË, NJËSIA ADMINISTRATIVE  
NIKËL, BASHKIA KRUIJË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KRUIJË  
SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objektit arsimor shkolla 9-vjeçare “Hajdar Zogu”, fshati Tapizë, njësia administrative Nikël, Bashkia Krujë, në vlerën 103 147 686 (njëqind e tre milionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.
2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e rindërtimit të objektit arsimor shkolla 9-vjeçare “Hajdar Zogu”, fshati Tapizë, njësia administrative Nikël, Bashkia Krujë, të jetë në vlerën 20 629 537 (njëzet milionë e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe të përballohet nga shpenzimet e fondit rindërtimit.

3. Caktimin e Bashkisë Krujë si njësi zbatuese për rindërtimin e objektit arsimor shkolla 9-vjeçare “Hajdar Zogu”, fshati Tapizë, njësia administrative Nikël, Bashkia Krujë.
4. Fondi për financimin e rindërtimit të objektit arsimor shkolla 9-vjeçare “Hajdar Zogu” i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar njësisë zbatuese, Bashkisë Krujë.
5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRACE**

**MINISTRI I SHËTETIT  
PËR RINDËRTIMIN**

**ARBEN AHMETAJ**

NR.PROT. 37/1  
DATË 12.1. 2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
BASHKISË KRUJË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

